



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/92
Datë: 10.08.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 gusht 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen Ekstraktet e procesverbaleve si dhe transkriptet nga mbledhjet 84 dhe 86 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhjet; 85, 87 dhe 88 elektronike\ korresponduese të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/92
Datë: 10.08.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 20 të Ligjit Nr. 06/L-084 të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 gusht 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Udhëzimi Administrativ për Themelimin dhe Funksionimin e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës.
2. Obligohet Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Udhëzimit nga pika 1. e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/92
Datë: 10.08.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe me Ligjin Nr. 05/L-009, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 gusht 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës për drejtorë të Bordit të Ndërmarrjes Publike Qendrore Hekurudhat e Kosovës – Trainkos, Sh. A. emëron këta kandidatë:
 - 1.1. Z. Nol Dedaj, kryesues;
 - 1.2. Z. Astrit Mehaj, anëtar;
 - 1.3. Znj. Drita Kadriu - Berisha, anëtare;
 - 1.4. Znj. Blerina Shamolli, anëtare;
 - 1.5. Z. Riza Spanca, anëtar;
 - 1.6. Z. Shaban Neziri, anëtar.
2. Të emëruarit nga pika 1. e këtij Vendimi kryejnë detyra dhe përgjegjësi në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe me Ligjin Nr. 05/L-009, dhe me dispozitat tjera ligjore në fuqi.
3. Mandati i të emëruarve nga pika 1. e këtij Vendimi zgjatë tre (3) vjet.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/92
Datë: 10.08.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe me Ligjin Nr. 05/L-009, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 gusht 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës për drejtorë të Bordit të Kompanisë Rajonale të Ujësjetësit Hidroregjioni Jugor Sh. A. Prizren, emëron këta kandidatë:
 - 1.1. Z. Feim Fetoshi, kryesues;
 - 1.2. Z. Hysni Çanta, anëtar;
 - 1.3. Znj. Mirlinda Morina, anëtare;
 - 1.4. Z. Biljal Karadolami, anëtar;
 - 1.5. Z. Naim Kukaj, anëtar;
 - 1.6. Z. Arben Hajrizi, anëtar.
2. Të emëruarit nga pika 1. e këtij Vendimi kryejnë detyra dhe përgjegjësi në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe me Ligjin Nr. 05/L-009, dhe me dispozitat tjera ligjore në fuqi.
3. Mandati i të emëruarve nga pika 1. e këtij Vendimi zgjatë tre (3) vjet.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/92
Datë: 10.08.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe me Ligjin Nr. 05/L-009, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 gusht 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës për drejtorë të Bordit të Kompanisë Rajonale të Ujitjes Radoniqi-Dukagjini Sh. A. Gjakovë, emëron këta kandidatë:
 - 1.1. Z. Ilir Dula, kryesues;
 - 1.2. Z. Vehbi Duraku, anëtar;
 - 1.3. Z. Krenar Bajgora, anëtar;
 - 1.4. Z. Agron Tafarshiku, anëtar.
2. Të emëruarit nga pika 1. e këtij Vendimi kryejnë detyra dhe përgjegjësi në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe me Ligjin Nr. 05/L-009, dhe me dispozitat tjera ligjore në fuqi.
3. Mandati i të emëruarve nga pika 1. e këtij Vendimi zgjatë tre (3) vjet.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/92
Datë: 10.08.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe me Ligjin Nr. 05/L-009, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 gusht 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës për drejtorë të Bordit të Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit Bifurkacioni Sh. A. Ferizaj, emëron këta kandidatë:
 - 1.1. Z. Naim Rexhaj kryesues;
 - 1.2. Z. Donat Rexha, anëtar;
 - 1.3. Znj. Kujtesa Mashkulli - Ahmeti, anëtare;
 - 1.4. Znj. Kujtesë Ibushi - Ramadani, anëtare.
2. Të emëruarit nga pika 1. e këtij Vendimi kryejnë detyra dhe përgjegjësi në pajtim me Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe me Ligjin Nr. 05/L-009, dhe me dispozitat tjera ligjore në fuqi.
3. Mandati i të emëruarve nga pika 1. e këtij Vendimi zgjatë tre (3) vjet.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/92
Datë: 10.08.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 23 të Ligjit Nr.08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive të ndryshuar dhe të plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në zbatim të Vendimit të Qeverisë Nr. 10/69 të datës 13 prill 2022 lidhur me mbështetjen e qytetarëve të Republikës së Kosovës në kuadër të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, Vendimit të Qeverisë lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike Nr.13/19 të datës 14 korrik 2021, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 12/31 të datës 25 gusht 2021, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 01/49 të datës 17 dhjetor 2021, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 15/62 të datës 23 shkurt 2022, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 04/90 të datës 26 korrik 2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 gusht 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Pika 1. e Vendimit Nr. 01/72 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të datës 27 prill 2022, plotësohet dhe ndryshohet me tekstin si në vijim:
 - 1.1 Aprovohet ndarja e mjeteve buxhetore prej 7,400,000 € (shtatë milionë e pesëqind mijë euro) për zbatimin e pikës 1.4 të Vendimit të Qeverisë Nr. 10/69 të datës 13 prill 2022, si masë për shtimin e mbështetjes për qytetarët e Republikës së Kosovës në kuadër të Masës 3.6 – Mbështetja e likuiditetit familjar, dhe përmbylljen e zbatimit të Masës 3.6 – Mbështetja e Likuiditetit Familjar, të Pakos së Ringjalljes Ekonomike sipas Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14 korrik 2021 i ndryshuar dhe plotësuar.
 - 1.2 Plotësimi dhe ndryshimi sipas pikës 1.1 të këtij Vendimi përbën ndarje shtesë prej 100,000 € (njëqind mijë euro) mbi ndarjen ekzistuese sipas Vendimit Nr. 01/72 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 27 prill 2022.
2. Pika 2. e Vendimit Nr. 01/72 të Qeverisë së Republikës së Kosovës të datës 27 prill 2022, plotësohet dhe ndryshohet me tekstin si në vijim:
 - 2.1 Mjetet e ndara sipas pikës 1.1 të këtij Vendimi merren nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me kod 201 nga nën-programi “Programi i Ringjalljes Ekonomike” me kod 29300, nga kategoria e shpenzimeve “Subvencione dhe Transfere” dhe ndahen në nën-programin “Thesari” me kod 11200, në kategorinë e shpenzimeve “Subvencione dhe Transfere”.

3. Pika 3. e Vendimit Nr. 01/72 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të datës 27 prill 2022, plotësohet dhe ndryshohet me tekstin si në vijim:


3.1 Mjetet sipas këtij Vendimi transferohen, buxhetohen dhe alokohen në kodin e përcaktuar (00098) në programin përkatës, për ekzekutimin e pagesës së subvencionimit për listën e përfituesve të gjeneruar sipas kriterëve dhe kushteve të përcaktuara me Vendime të Ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve sipas autorizimeve të pikës 3. të Vendimit të Qeverisë Nr. 10/69 të datës 13 prill 2022 dhe pikës 2. të Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14 korrik 2021.

4. Pikat tjera të Vendimit Nr. 01/72 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të datës 27 prill 2022, mbesin të pandryshuara dhe në fuqi, ashtu si edhe veprimet e ndërmarra për zbatimin e Vendimit Nr. 01/72 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të datës 27 prill 2022.

5. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për zbatimin e këtij Vendimi.

6. Vendimi hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/92
Datë: 10.08.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, të nenit 66 paragrafi 1. dhe 5. të Ligjit Nr.04/L 147 për Ujërat e Kosovës, nenit 32, 33 dhe 34 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.15/2017 për Kriteret për Përcaktimin e Zonave të Mbrojtura Sanitare të Burimeve të Ujit, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 gusht 2022, merr këtë:

V E N D I M

Për përcaktimin e zonave të mbrojtura sanitare dhe masat e tyre mbrojtëse të burimit ujor nëntokësor që përdoret për pije - "Puset e Konjuhut", Komuna Lipjan

1. Qëllimi i përcaktimit të zonave të mbrojtura sanitare është që të mbrojnë burimet e ujit nëntokësor - "Puset Konjuh", Komuna Lipjanit, nga ndikimet negative të cilat mundë të dëmtojnë gjendjen normale dhe të qëndrueshme të ujit nga aspekti i cilësisë dhe sasisë.
2. Ky vendim ka për bazë studimin kryesor dhe elaboratin e zonave të mbrojtura sanitare sipas nenit 38 të Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2017 për Kriteret për Përcaktimin e Zonave të Mbrojtura Sanitare të Burimeve të Ujit.
3. Burimet ujore nëntokësore "Puset e Konjuhut", i përkasin llojit të burimeve të ujërave nëntokësor në akuifer intergranular.
4. Zonat e mbrojtura përfshijnë hapësirën nga burimi ujor nëntokësor deri te ujëndarësi hidrogeologjik i burimit, si dhe objektet me pajisjet për marrjen e ujit.
5. Zonat e mbrojtura të burimit të ujit nëntokësor - "Puset e Konjuhut", ndahen në:
 - 5.1. Zona I mbrojtëse;
 - 5.2. Zona II mbrojtëse; dhe
 - 5.3. Zona III mbrojtëse.
6. Mbikëqyrjen e zonave të mbrojtura sanitare dhe zbatimin e masave mbrojtëse e bënë Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (në tekstin e mëtejshëm Ministria).
7. KRU "Prishtina", është përgjegjëse për mirëmbajtjen e zonave të mbrojtura sanitare dhe vendosjen e shenjave paralajmëruese në zonën I dhe në zonën II të mbrojtur dhe duhet të hartoj raport vjetor për gjendjen në zonat e mbrojtura për Ministrinë.
8. Pjesë përbërëse e këtij vendimi, si shtojcë është harta gjeologjike dhe hidrogeologjike e pellgut të burimit në përpjesë 1:25000 e cila është e deponuar në Ministri/Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore.

9. Zona I - Zona e Kufizimit:

- 9.1. Kufiri i zonës I mbrojtëse paraqet vijën e cila duhet të jetë e larguar së paku 10 (dhjetë) metra nga të gjitha anët e veprës ujë marrëse me objektet përcjellëse;
- 9.2. Hapësira e zonës I, të mbrojtur sanitare, duhet të jetë e rrethuar nga objekti për marrjen e ujit me të gjitha objektet tjera me rrethojë të fortë në mënyrë që të pengohet hyrja e kafshëve apo personave të pa-autorizuar si dhe vendosja shenjave;
- 9.3. Në zonën I, të mbrojtur sanitare ndalohen të gjitha aktivitetet të cilat nuk janë të lidhura me operimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të furnizimit me ujë;
- 9.4. Përjashtim nga nën-pika 11.3, e kësaj pike të këtij Vendimi , lejohen aktivitete si vijon:
 - 9.4.1. Kultivimi i barit pa përdorimin e plehrave dhe preparateve tjera kimike;
 - 9.4.2. Shtrirja e kanalizimit dhe instalimeve tjera, të cilat shërbejnë për punën e objektit për furnizimin me ujë, me ç 'rast me projektin përkatës dhe zgjidhjet ekzistuese, duhet të sigurohet që zbatimi i punimeve të mos rrezikohet siguria dhe cilësia e ujit në burim.

10. Zona II - Zona e Kontrolluar:

- 10.1. Kufiri i zonës II të mbrojtur për burimet ujore nëntokësore "Puset e Konjuhut", duhet të jetë së paku 100 (njëqind) metra nga zona I e mbrojtur .
- 10.2. Në zonën II mbrojtëse të burimeve nëntokësorë në akuifer intergranular ndalohet zhvillimi i aktiviteteve dhe kryerja e punimeve që mund të ndotin ujin, veçanërisht:
 - 10.2.1. Shkarkimi i ujërave të ndotura të pa trajtuara të kanalizimit;
 - 10.2.2. Ndërtimi dhe operimi i reparteve industriale dhe zejtare të cilat lëshojnë materie radioaktive dhe materie tjera petrokimike dhe kimike;
 - 10.2.3. Grumbullimi dhe deponimi i të gjitha llojeve të mbeturinave;
 - 10.2.4. Deponimi hapur i plehrave kimike, të kafshëve dhe përdorimi i pesticideve;
 - 10.2.5. Ndërtimi dhe shfrytëzimi i fermave të shpezëve dhe kafshëve;
 - 10.2.6. Ndërtimi dhe nxjerrja e ujit të burimeve dhe puseve që nuk shfrytëzohen për furnizim publik;
 - 10.2.7. Ndërtimi dhe shfrytëzimi i tubacioneve që transportojnë materie kimike, karburante, vajra dhe materie tjera të rrezikshme;
 - 10.2.8. Përpunimi deponimi apo manipulimi me materie kimike, karburante, vajra dhe materie tjera të rrezikshme për cilësinë e ujit;
 - 10.2.9. Ndërtimi dhe operimi i impianteve për përdorimin, përpunimin ose deponimin e mbeturinave të rrezikshme;
 - 10.2.10. Ndërtimi dhe puna e reparteve industriale, të cilat mund të lëshojnë materie të dëmshme për cilësinë e ujit;
 - 10.2.11. Transporti rrugor i materieve radioaktive, kimike, karburanteve të lëngëta, vajra dhe materieve tjera të rrezikshme;
 - 10.2.12. Kryerja e shpimeve hulumtuese për naftë, gazë tokësor dhe materie tjera të rrezikshme, nëse nuk janë ndërmarrë masa për pengimin e infiltrimit dhe derdhjes së këtyre materieve në ujëra nëntokësor;
 - 10.2.13. Ndërtimi i auto udhëve, aeroporteve, parkingjeve ose hapësirave tjera transportuese pa largim të kontrolluar dhe trajtim të ujërave atmosferik para shkarkimi në recipient;
 - 10.2.14. Eksploatimi i zhavorrit dhe rërës;
 - 10.2.15. Ndërtimi i varrezave të reja apo zgjerimin i varrezave ekzistuese;
 - 10.2.16. Aktivitetet tjera të cilat konstatohet se mund të kenë pasoja negative në burimin e ujit.

11. Zona III - Zona e Mbikëqyrur:

- 11.1. Territori i zonës III mbrojtëse për burimet në akuifer integranular përfshinë hapësirën jashtë kufirit të zonës II të mbrojtur deri te ujëndarësi hidrogeologjik.
- 11.2. Në territorin e zonës III mbrojtëse, ndalohet ekzekutimi i punimeve, ndërtimi i objekteve dhe zhvillimi i aktiviteteve me të cilat mund të ndoten ujërat e burimit, veçanërisht:
 - 11.2.1. Shkarkimi i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë i ujërave të ndotura të pa trajtuara në ujë dhe tokë;
 - 11.2.2. Ndërtimi dhe operimi i reparteve industriale dhe aktiviteteve të cilat mund të lëshojnë materie radioaktive dhe materie tjera kimike të dëmshme për cilësinë e ujit;
 - 11.2.3. Grumbullimi dhe deponimi i të gjitha llojeve të mbeturinave;
 - 11.2.4. Ndërtimi dhe operimi i impianteve për përdorimin, përpunimin ose deponimin e mbeturinave të rrezikshme;
 - 11.2.5. Ndërtimi i auto udhëve, aeroporteve, parkingjeve ose hapësirave tjera transportuese pa largim të kontrolluar dhe trajtim të ujërave atmosferik para shkarkimi në recipient;
 - 11.2.6. Kryerja e shpimeve hulumtuese për naftë, gazë tokësor dhe materie tjera të rrezikshme, nëse nuk janë ndërmarrë masa për pengimin e infiltrimit dhe derdhjes së këtyre materieve në ujëra nëntokësorë;
 - 11.2.7. Deponimi hapur i plehrave kimike, të kafshëve dhe përdorimi i pesticideve;
 - 11.2.8. Ndërtimi i varrezave të reja apo zgjerimin i varrezave ekzistuese;
 - 11.2.9. Aktivitetet tjera të cilat konstatohen se mund të kenë pasoja negative në burimin e ujit.

12. Masat Mbrojtëse në zonën I dhe II:


- 12.1. Vendosja e sistemit për monitorimin e ujit të burimeve ujore nëntokësorë, "Puset e Konjuhut", Komuna e Lipjanit;
- 12.2. Vendosja e sistemit për mbikëqyrjen dhe menaxhimin e mbeturinave;
- 12.3. Për aktivitetet bujqësore që zhvillohen në këto zona të rrezikuara nga ndikimet antropogjenë, hartohen masat e veçanta, duke u bazuar nga rezultatet e monitorimit të cilësisë së ujit dhe zbatimit të dispozitave të ligjeve në fuqi, Direktiva Nitrateve 91/676/ e KE dhe Kodit për Praktika të mira Bujqësore;
- 12.4. Komuna e Lipjanit në bashkëpunim me Ministrin e Linjës, mirëmbajnë dhe kontrollojnë gjendjen e lumit "Janjevka", mbeturinat dhe shkarkimet e ujërave të ndotura;
- 12.5. Mbikëqyrja e rregullt e ujëmbledhësve të ujërave atmosferik nga auto udha Arbër Xhaferi" - kycja Lipjan - Hani i Elezit dhe magjistralja Prishtinë - Ferizaj, që përshkon në zonat e ujërave nëntokësorë të akuiferit, "Puset e Konjuhut";
- 12.6. Për transportin e mallrave të rrezikshme në zonë mbrojtëse duhet të merren masa sipas Ligjit Nr.04/L- 183 për Transportin e Mallrave të Rrezikshme;
- 12.7. Të vendosen tabelat me shenja informative në kufirin e zonës I dhe II
- 12.8. Si masë shtesë KRU "Prishtina", bënë investime në sistemin e monitorimit për cilësinë e ujit sipas standardeve në fuqi dhe Udhëzimit Administrativ Nr.10/2021, për Cilësinë e Ujit të Destinuar për Konsum Njerëzor;
- 12.9. Për ndërtimin e objekteve të reja dhe ato ekzistuese duhet t'i nënshtrohen procedurave administrative për t'u pajisur me Pëlqim Mjedisor, sipas:
 - 12.9.1. Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim, Ligjit Nr.03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit dhe akteve tjera ligjore në fuqi;
 - 12.9.2. Ndërtimet pa leje që nënkuptohen objektet e ndërtuara në kundërshtim me dispozitat dhe procedurat e përcaktuara sipas Ligjit Nr.04/L-110 të Ndërtimit dhe Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor;

- 12.9.3. Investimet dhe zhvillimet e projekteve me potencial ndotës të burimit të ujit;
12.9.4. Objektet afariste të cilat nuk kanë leje për punë.

13. Masat mbrojtëse në zonën III:

- 13.1. Për t'u pajisur me Pëlqim Mjedisor dhe Autorizim Mjedisor për zonën III, mbrojtëse, aplikohen procedurat administrative sipas pikës 14, nënpika 14.9 të këtij Vendimi;
13.2. Për aktivitete bujqësore, të zbatohen dispozitat e ligjeve në fuqi dhe Kodit për Praktika të Mira Bujqësore.
14. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/92
Datë: 10.08.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 14 pika 3. të Ligjit Nr.08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 gusht 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet riallokimi i mjeteve financiare në shumë prej 1,080.768 € (një milion e tetëdhjetë mijë shtatëqind e gjashtëdhjetë euro) në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal me kod 212, nën-programi Administrata Qendrore me kod 11312, nga kategoria shpenzime kapitale, konkretisht nga projekti: "Programi komunal për zhvillim të infrastrukturës socio-ekonomike dhe bashkëpunim ndër-komunal" me kod 15633 në 7 (shtatë) projekte kapitale në përputhje me 7 (shtatë) marrëveshjet e mirëkuptimit për projekte kapitale të nënshkruara nga Ministri i MAPL-së dhe kryetarët e komunave.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi riallokohen nga projekti: "Programi komunal për zhvillim të infrastrukturës socio-ekonomike dhe bashkëpunim ndër-komunal" me kod 15633 në këto projekte të reja, konform shumave të cekura si në vijim:
 - 2.1. Projekti "Rregullimi i trotuarit dhe shtegut të biçikletave me infrastrukturë përcjellëse nga qyteti i Klinës deri te udhëkryqi Pejë-Prishtinë", Komuna e Klinës, në vlerë prej 130,000.00 €;
 - 2.2. Projekti "Parku Baja ", Komuna e Gjilanit, në vlerë prej 87,500.00 €;
 - 2.3. Projekti "Rehabilitimi i infrastrukturës fizike të komunitetit Rom, Ashkali dhe Egjiptian, në Plemetin, Komuna e Obiliqit, në vlerë prej 100,000.00 €;
 - 2.4. Projekti "Podujeva për Eficiencë dhe Zhvillim Efikas", Komuna e Podujevës, në vlerë prej 111,114.00 €;
 - 2.5. Projekti "Rregullimi i parkut në fshatin Davidoc, Komuna e Shtimës në vlerë prej 113,727.00 €;
 - 2.6. Projekti i bashkëpunimit ndër komunal "Zhvillimi i infrastrukturës rrugore dhe bujqësore në komunën e Istogut dhe atë të Pejës", Komuna e Istogut lidere, në vlerë prej 238,467.00 €;
 - 2.7. Projekti i bashkëpunimit ndër komunal "Lugu i verdhë", Komuna Kamenicë-Novobërdë, Komuna e Kamenicës lidere në vlerë prej 299,960.00 €.
3. Obligohet Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, për zbatimin e këtij Vendimi.

4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/92
Datë: 10.08.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 55 paragrafi 1. të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 gusht 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Shfuqizohen Vendimet e Qeverisë Republikës së Kosovës si në vijim; Nr. 04/57 i datës 17 korrik 2018, Nr. 05/57 i datës 17 korrik 2018, Nr. 06/57 i datës 17 korrik 2018, Nr. 07/59 i datës 31 korrik 2018, Nr. 11/60 i datës 7 gusht 2018, Nr. 12/60 i datës 7 gusht 2018, Nr. 17/61 i datës 22 gusht 2018, Nr. 12/62 i datës 28 gusht 2018, Nr. 10/65 i datës 13 shtator 2018, Nr. 11/65 i datës 13 shtator 2018, Nr. 06/66 i datës 18 shtator 2018, Nr. 09/69 i datës 16 tetor 2018, Nr. 10/69 i datës 16 tetor 2018, Nr. 11/71 i datës 23 tetor 2018, Nr. 07/74 i datës 6 nëntor 2018, Nr. 08/74 i datës 6 nëntor 2018, dhe Vendimi Nr. 09/74 i datës 6 nëntor 2018, me qëllim të kthimit të ligjshmërisë.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.


A r s y e t i m

Bazuar në kërkesat për tërheqjen nga procesi i privatizimit dhe kthimin e pronave të administruara nga AKP te komunat, Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar vendimet, tani me këtë Vendim të shfuqizuar, të listuara në paragrafin 1. të këtij Vendimi.

Këto vendime nuk kanë prodhuar efekte juridik, marrë parasysh që asnjëherë nuk është përmbyllur procesi i bartjes së pronave të AKP-së te komunat, pasi bordi i AKP-së nuk ka miratuar asnjë kërkesë të komunave si organ përfundimtar në këtë procedurë.

Në vazhdim, marrë parasysh që në vitin 2019 ka hyrë në fuqi Ligji Nr. 06/L-092 që ka shfuqizuar Ligjin Nr. 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, mbi bazën e të cilit janë marrë vendimet si më lart, të njëjtat shfuqizohen në qëllim të kthimit të ligjshmërisë.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/92
Datë: 10.08.2022

Në mbështetje të nenit 17, nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 7 paragrafit 5 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 gusht 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi për të kërkuar nga Presidentja e Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit Zëvendëskryeministrit të parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog, z. Besnik Bislimi, për nënshkrimin e Marrëveshjes Financiare për IPA 2021 ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian.
2. Rekomandohet Presidentja e Republikës së Kosovës për dhënien e autorizimit për nënshkrimin e Marrëveshjes nga pika 1. e këtij Vendimi në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/92
Datë: 10.08.2022

Në mbështetje të nenit 17, nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 7 paragrafit 5 të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 gusht 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi për të kërkuar nga Presidentja e Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit Zëvendëskryeministrit të parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog, z. Besnik Bislimi, për nënshkrimin e Amendamentimit 2. të Marrëveshjes Financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Programin IPA 2018.
2. Rekomandohet Presidentja e Republikës së Kosovës për dhënien e autorizimit për nënshkrimin e Marrëveshjes nga pika 1. e këtij Vendimi në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/92
Datë: 10.08.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 26 të Ligjit Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 gusht 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti i Punës i Këshillit të Kosovës për Raportim Financiar për periudhën korrik 2021- qershor 2022.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/92
Datë: 10.08.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 gusht 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Këshilli Organizativ për shënimin e 25 (njëzetepesë) vjetorit të kalimit në amshim të humanistes së madhe shqiptare, Nënë Terezës, në këtë përbërje:
 - 1.1. Hajrulla Çeku, Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, kryesues;
 - 1.2. Vehbi Miftari, përfaqësues i Zyrës së Presidentes, anëtar;
 - 1.3. Reshat Nurboja, përfaqësues i Kuvendit të Kosovës, anëtar;
 - 1.4. Shenaj Shala, përfaqësuese e Zyrës së Kryeministrit të Kosovës, anëtare;
 - 1.5. Vllaznim Osmani, përfaqësues i Komunës së Prishtinës, anëtar;
 - 1.6. Don Fatmir Koliqi, përfaqësues i Ipeshkvisë së Kosovës, anëtar;
 - 1.7. Sali Shoshi, përfaqësues i shoqërisë civile, anëtar;
 - 1.8. Zanita Halimi, studiuese, anëtare;
 - 1.9. Jahja Drançolli, studiues, anëtar.
2. Obligohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 15/92
Datë: 10.08.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 23 të Ligjit Nr.08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, të Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14 korrik 2021 lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 12/31 të datës 25 gusht 2021, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 01/49 të datës 17 dhjetor 2021, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 15/62 të datës 23 shkurt 2022, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 04/90 të datës 26 korrik 2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 gusht 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet ndarja e mjeteve buxhetore në vlerë prej 600,000 € (gjashtëqind mijë euro) në zbatim të Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14 korrik 2021, i ndryshuar dhe plotësuar, lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, për Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve me kod 201, në nën programin "Thesari" me kod 11200, në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", në kuadër të Masës 2.4 – Mbështetja e eksportit.
2. Mjetet e ndara sipas pikës 1. të këtij Vendimi merren nga nën-programi "Programi i Ringjalljes Ekonomike" me kod 29300, nga kategoria e shpenzime "Subvencione dhe Transfere.
3. Mjetet sipas këtij Vendimi transferohen, buxhetohen dhe alokohen në kodin e përcaktuar (00098) të organizata buxhetore dhe programi përkatës.
4. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve për zbatimin e këtij Vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 16/92
Datë: 10.08.2022


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 23 të Ligjit Nr.08/L-066 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2022, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, të Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14 korrik 2021 lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 12/31 të datës 25 gusht 2021, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 01/49 të datës 17 dhjetor 2021, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 15/62 të datës 23 shkurt 2022, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin Nr. 04/90 të datës 26 korrik 2022, Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Nr.1800/3 të datës 9 gusht 2022 për miratimin e Vendimit Nr. 01/91 të datës 31 korrik 2022 të Qeverisë, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 gusht 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Ekonomisë për ndarje buxhetore në shumë prej 40,000,000.00 € (dyzetë milionë euro), për zbatimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 13/19 të datës 14 korrik 2021, i ndryshuar dhe plotësuar, lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike për zbatimin e Masës 4.6 – Mbështetja e ndërmarrjeve publike.
2. Mjetet e ndara sipas pikës 1. të këtij Vendimi merren nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve me kod 201, nën-programi “Programi i Ringjalljes Ekonomike” me kod 29300, kategoria e shpenzimeve “Subvencione dhe Transfere”, dhe transferohen në Ministrinë e Ekonomisë me kod 213, në nën-programin “Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike” me kod 23300, në kategorinë e shpenzimeve “Subvencione dhe Transfere”.
3. Autorizohet Ministria e Ekonomisë që mjetet nga pika 1. e këtij Vendimi t’ia transferojë ndërmarrjes publike KOSTT Sh. A. për përmbushjen e obligimeve ndaj ENTSO-E, në përputhje me pikën 6 të Vendimit të Qeverisë Nr. 01/91 të datës 31 korrik 2022, të miratuar nga Kuvendi sipas Vendimit Nr.1800/3 të datës 9 gusht 2022, për masat e emergjencës në furnizimin e energjisë.
4. Kushtet dhe kriteret e shfrytëzimit të mjeteve nga pika 1. e këtij Vendimi përcaktohen me Marrëveshje që lidhet në mes të Ministrisë së Ekonomisë dhe KOSTT Sh. A.
5. Mjetet sipas këtij Vendimi transferohen, buxhetohen dhe alokohen në kodin e përcaktuar (00098) të organizata buxhetore dhe programi përkatës.
6. Obligohen Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Ekonomisë për zbatimin e këtij Vendimi.

7. Vendimi hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 17/92
Datë: 10.08.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 5 paragrafi 1. lidhur me nenin 19, paragrafi 3, dhe nenit 43, paragrafi 1. të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 22 i ndryshuar dhe plotësuar me Nr. 04/L-111 dhe me Ligjin Nr. 05/L-009, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 10 gusht 2022, merr këtë:

V E N D I M

1. Shkarkohen nga detyra në Bordin e Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike "Infrakos", Sh. A. z. Afrim Mehmetaj, z. Selatin Retkoceri dhe z. Ilir Zhitia.
2. Emërohet Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve të Ndërmarrjes Publike "Infrakos" Sh. A. me këtë përbërje:
 - 2.1. Z. Dukagjin Kastrati, kryesues;
 - 2.2. Znj. Besarta Zuka, anëtare;
 - 2.3. Z. Shpend Gjuga, anëtar;
 - 2.4. Z. Genc Hundozi, anëtar.
3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Bordi i Ndërmarrjes Publike "Infrakos" Sh. A. ka ngecur në realizimin e objektivave afariste. Meqenëse për këtë ngecje nuk ka shkaqe objektive që do të mund të merreshin parasysh, Qeveria konsideron se Bordi i Drejtorëve është duke bërë shkelje të detyrave fiduciare duke mos adresuar me efikasitetin e duhur morinë e problemeve me të cilat kjo ndërmarrje ballafaqohet. Marrë parasysh këtë, Qeveria vendosi si në dispozitiv.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government
Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije /Ministry of Economy

MEMORANDUM SHPJEGUES

Prishtinë, 10.08.2022

Duke u mbështetur në Ligjin Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, neni 5.1, Qeveria ka kompetencën ekskluzive për ushtrimin e të drejtave të aksionarit të Republikës së Kosovës në Ndërmarrjet Publike (NP) Qendrore si dhe nenin 4 të Ligjit Nr. 04/l-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/l-087 për Ndërmarrjet Publike, Aksionari(ët) e një NP nëpërmjet Njësisë për Politikën dhe Monitorimin e NP-ve do të ushtrojë mbikëqyrje të vazhdueshme dhe rigoroze të veprimtarisë së Bordit të Drejtorëve dhe Komisioneve të Auditimit të NP-së në fjalë.

Sipas nenit 12 të Ligjit Nr.03/l-087, Detyrimet e Përgjithshme të NP dhe Drejtorëve të saj, paragrafi 12.1 Ndërmarrja Publike e ushtron veprimtarinë me qëllim të rritjes afat-gjate të vlerës së ndërmarrjes dhe aksionarëve.

Në Rregulloren (QRK) – Nr.02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, neni 30 shtojca 13 Ministria e Ekonomisë (ME) në paragrafët 13.5 dhe 13.6 janë përcaktuar përgjegjësitë e Ministrisë në ushtrimin e të drejtave të Aksionarit:

13.5. Ndhmon Qeverinë në ushtrimin e të drejtave të Aksionarit dhe kryeson Komisionin Ministror për Ndërmarrjet Publike;

13.6. Mbikëqyr dhe vlerëson Bordet e Drejtorëve të Ndërmarrjeve Publike sipas legjislacionit

Kërkesa për shkarkimin e anëtarëve të Bordi të Rregullt të Drejtorëve të NP Infrakos Sh.a, emëruar me Vendimin Nr.08/67 të Qeverisë së Republikës së Kosovës datë 09.03.2022, bëhet për arsye se Bordi ka ngecur në realizimin e objektivave afariste. Meqenëse për këtë ngecje nuk ka shkaqe objektive që do të mund të merreshin parasysh, Qeveria konsideron se Bordi i Drejtorëve është duke bërë shkelje të detyrave fiduciare duke mos adresuar me efikasitetin e duhur morinë e problemeve me të cilat kjo ndërmarrje ballafaqohet.

Sipas nenit 19.3, Qeveria duhet t'i shkarkoj drejtorët menjëherë nëse ka'' arsye për të besuar'' se Bordi i Drejtorëve ka shkelur detyrat e tyre fiduciare. Pas shkarkimit të Bordi të Drejtorëve të NP Infrakos Sh.a, emërimi i një Bordi të Përkohshëm është i pashmangshëm deri në zgjedhjen e

Bordit të rregullt, me qëllim që të vazhdohet veprimtaria dhe ngritja e performancës së ndërmarrjes, çka është edhe synim i Qeverisë së Republikës së Kosovës si Aksionar.

Mbështetur në nenin 43 të ligjit bazik, paragrafi 43.1 të riformuluar sipas nenit 22 të Ligjit Nr. 04/l-111 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.03/L-087 për ndërmarrjet publike "Qeveria është e autorizuar që ta emërojë një Bord të Përkohshëm të Drejtorëve ("Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve") për secilën NP për të shërbyer në cilësinë e Bordit të Drejtorëve të NP-së për një periudhë gjashtëmujore, nga shkarkimi i bordit aktual deri në përzgjedhjen e bordit të përhershëm në përputhje me nenin 15 të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike."